



Prishtinë, 28 janar 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_763\_2016

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 16 paragrafi 4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimi për Lëshimin e Autorizimit V-568-2013 të datës 24 Tetor 2013 për shoqërinë "Kelkos-Energy" sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Lumëbardhi II., me kapacitet të instaluar prej **5.5 MW**, njësia gjeneruese që do të vendosen në lokacionin e lumit Deçan, komunën e Deçanit;
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Autorizimit V\_568\_2013 të datës 24 Tetor 2013, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Lumëbardhi II., me kapacitet të instaluar prej **5.5 MW**, që do të vendosen në lokacionin e lumit Deçan, në Komunën e Deçanit, të datë 21.10.2015 të shoqërisë "Kelkos-Energy" sh.p.k., me adresë rruga "Sali Ceku" ndërtesa Gogaj,51000, nr. 14, Deçan, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë **28 janar 2016** nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit V\_568\_2013 i datës 24 tetor 2013, i shoqërisë "Kelkos-Energy" sh.p.k., për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Lumëbardhi II., me kapacitet të instaluar prej **5.5 MW**, që do të vendosen në lokacionin e lumit Deçan, në komunën e Deçanit, edhe për një (1) vit, gjegjësisht **deri me 24 tetor 2016**.

## A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 09.08.2010 nga shoqëria "Kelkos-Energy" sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, me kapacitet të instaluar prej 23.1 MW, në lokacionet: Lumëbardhi II. me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, HC Belaja me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW dhe HC Deçan me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW, të gjitha në Komunën e Deçanit.
- o Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmive të prezantuara nga shoqëria "Kelkos-Energy" sh.p.k., ka vendosur se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_296\_2010 me datë 11 nëntor 2010. Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, i cili nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e



Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.

- ZRRE me datë 09.11.2012 nga shoqëria “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V- 296-2010 të datës 11 nëntor 2010, edhe për një afat gjashtë (6) mujor, për mundësin e kompletimit të aplikacionit.
- ZRRE me datë 30 nëntor 2012 ka vendosur me vendimin V-402-2012 që shoqërisë “ Kelkos \_ Energy” sh.p.k., ti shtyhet afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-296-2010 i datës 11 nëntor 2010 edhe për një afat gjashtë(6) mujor, gjegjësisht deri me 11 maj 2013.
- ZRRE me datë 28.05.2013 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar njoftimin se procesi në lidhje me HC Lumëbardhi II me kapacitet prej 5.5 MW, i shoqërisë “ Kelkos –Energy” sh.p.k., është në fazën e fundit, ku MMPH së fundmi ka lëshuar Lejen Urbanistike dhe shpejti do të lëshohet edhe Leja e Ndërtimit, e cila do të kompletton procedurën për marrjen e Autorizimit në ZRRE.
- ZRRE me datë 27.09.2013 nga shoqëria “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji në Autorizim Final për HC Lumëbardhi II me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 24.10.2013 ka vendosur që shoqërisë “Kelkos-Energy” sh.p.k., ti lëshohet Autorizimi V\_568\_2013 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Lumëbardhi II me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, që do të vendoset në lokacionin e lumit Deçan të Komunën e Deçanit.
- ZRRE me datë 21.10.2015 nga shoqëria “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V\_568\_2013 të datës 24 tetor 2013, për HC Lumëbardhi II me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, **për kompletimin e ndërtimit edhe për një (1) vit.**
- *Shoqëria “Kelkos-Energy” sh.p.k., në kërkesën e saj ka sqaruar se:ndërtimi i këtij hidrocentrali është duke u bërë në një teren shumë të vështirë( lugina të vogla, shpatet e pjerrëta, rrugë të ngushta, toka shkëmbore, ndryshimet e forta klimatike, mungesa e infrastrukturës publike,) dhe pjesërisht në Zonën e Veçantë të Mbrojtjes së Manastirit të Deçanit dhe Zonës së Parkut Kombëtar. Përkundër vështirësive punimet në ndërtimin e këtij hidrocentrali kanë filluar në fillim të vitit 2014, ku janë përgatitur forma e ardhshme e rezervuarit, është bërë analizimi i materialit në drejtim të stabilitetit për ndërtimin e digës, janë hetuar nivelet e ujit dhe e tërë zona në vendndodhje, në mënyrë që të finalizohet projekti dhe pozitat instaluese të HC Lumëbardhi II. Punimet e projektimit në detaje priten të përfundohen në dimër të vitit 2015. Për shkak të lartësisë dhe motit, punimet duhet të ndërpriten çdo vit gjatë4-5 muaj të dimrit (nëntor –mars), për shkak të dëborës , temperaturat e ulëta dhe qasja e pamundur në rrugë. Vazhdimi i punimeve të ndërtimit të basenit, punimet rreth ndërtesës së HC Lumbardhi II., janë planifikuar në fillim të vitit 2016, sapo moti dhe situata të lejon. Andaj, bazuar në këtë*





shoqëria në fjalë, me arsyetimin e dhënë më lartë ka kërkuar që të shtyhet afati prej një (1) viti për kompletimin e ndërtimit.


- o ZRRE pas analizimit të kërkesës për shtyerje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, të shoqërisë “Kelkos-Energy” sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lumëbardhi i Deçanit: për HC Lumbarëdhi II. me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, në Komunën e Deçanit” ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim V\_568\_2013 i datës 24 tetor 2013, pas skadimit të afatit të përcaktuar në dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi mund të shfuqizohet me datë **24 tetor 2016**, në rast se pala nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- III. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


**Bordi i ZRRE-së:**

  
Enver Halimi, kryesues

  
Krenar Bujupi, anëtar

  
Arsim Janova, anëtar

  
Qemajl Mustafa, anëtar

  
Besim Sejfiqaj, anëtar